

1 E premte, 14 janar 2022

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I dyshuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 14.30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve brenda
7 dhe jashtë sallës.

8 Zoti Sekretar ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita i nderuar
10 Gjykatës. KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër
11 Pjetër Shalës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Sekretar.

13 Tani u lutem palëve dhe pjesëmarrësve të prezantohen duke
14 filluar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

15 Zoti Prokuror.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës.

17 Sot për Prokurorinë paraqiten Bernard Kuschnik, oficer
18 juridik; Marlene Yahya Haga, oficere për nxjerrjen dhe çështje
19 juridike; dhe unë, [si dhe] për Prokurorinë, Daniel Mezei.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Ia jap fjalën Mbrojtjes.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

23 Unë jam Jean-Louis Gilissen, Kryembrojtës. Kam këtu për të
24 ndihmuar zotin Aouini, që e njihni shumë mirë. Është dhe zonja
25 Kokaj që është nga Shqipëria. Kemi dhe zotin Shala i cili

1 është i lidhur me videolidhje.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Vë re se zoti
3 Shala ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në
4 sallë dhe se e përcjell seancën për ecurinë e çështjes përmes
5 videolidhje.

6 ia jap fjalën Zyrës Administrative.

7 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit. Mirëdita i nderuar
8 Gjykatës. Jam Jonas Nilsson nga Divizioni i Shërbimeve
9 Gjyqësore të Zyrës Administrative.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Për procesverbalin, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i
12 procedurës paraprake.

13 Më 20 dhjetor caktova datën për konferencën e pestë për
14 ecurinë e çështjes. Qëllimi im sot është të shqyrtojmë ecurinë
15 e çështjes dhe të organizoj shkëmbime midis palëve për të
16 siguruar përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.

17 Në veçanti, dëshiroj të diskutojmë për nxjerrjen e
18 materialeve, për përkthimet, ecurinë e hetimeve të Prokurorit
19 të Specializuar, ecurinë e hetimeve të Mbrojtjes, pikat
20 juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen, paraburgimin
21 dhe në fund, ndonjë çështje tjetër që dëshirojnë të ngrenë
22 palët.

23 Falënderoj ZPS-në dhe Mbrojtjen për parashtrimet e bëra
24 paraprakisht të kësaj konferencë për ecurinë e çështjes dhe si
25 zakonisht do t'u kërkoj palëve të paraqesin qëndrimet e tyre

1 në mënyrë koncize për çdo pikë të rendit të ditës, të cilat do
2 t'i marr me radhë.

3 Të fillojmë me pikën e parë të përcaktuar në rendin e
4 ditës, që është nxjerrja. Do t'ua jap fjalën palëve veçmas për
5 çdo kategori të materialit provues. Siç vepruam herën e fundit
6 do të kemi materialin e rregullës 102(3) që është materiali me
7 rëndësi për çështjen, siç është përcaktuar nga ZPS-ja.
8 Materiali i rregullës 103 që është materiali shfajësues dhe
9 materiali i rregullës 107 që është materiali i mbrojtur, për
10 të cilin kërkohet dhënia e autorizimit nga dhënësi i
11 informacionit.

12 Përpara se të flasim për nxjerrjen e këtyre
13 informacioneve, vërej se ZPS-ja ka nxjerrë mbrëmë materiale të
14 rregullës 102(1)(b), megjithëse kishte konfirmuar se e kishte
15 përfunduar nxjerrjen e materialeve të tilla në konferencën e
16 mëparshme për ecurinë e çështje.

17 Kështu që zoti Prokuror, ju lutem të na jepni më shumë
18 hollësi për këtë paketë të fundit të nxjerrjes. Faleminderit.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është e vërtetë që në
20 konferencën e fundit për ecurinë e çështje ne informuam se e
21 kishim mbaruar nxjerrjen për materialet e rregullës 102(1).
22 Mbase më me saktësi kishin mbetur tre materiale. I nderuari
23 Gjykatës autorizoi nxjerrjen e tretë në vendimin F72 në pritje
24 të marrjes së masave mbrojtje në Çështjen numër 6.

25 Këto janë dokumente të cilat ishin objekt i këtij vendimi

1 dhe në vijim të nxjerrejs së këtij vendimi atëherë ne i nxorëm
2 këto materiale me të njëjtat masa mbrojtëse në këtë çështje
3 gjyqësore.

4 Janë tre nga gjashtë dokumentet që dolën mbrëmë. Tre të
5 tjerat, dy ishin transkripti anglisht dhe shqip i një videoje
6 që ishte nxjerrë më përpara, i nderuar Gjykatës, si pjesë e
7 Paketës 11, më datë 31 korrik 2021. Ndërsa tjetri është
8 përkthimi i pjesës përkatëse së STIF00020142, që është nxjerrë
9 në paketën 12, më datë 1 shtator.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe janë bërë këto me
11 kërkesë të Mbrojtjes, pra përkthimi, këto nxjerrje shtesë të
12 përkthimit dhe transkripti?

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne e bëmë se ishte pjesë e
14 detyrimeve sipas rregullës 102(1)(b). Në lidhje me këtë e
15 bëmë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk ka ndonjë arsye pse nuk
17 u bë para disa muajsh dhe është bërë tani?

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Arsyen specifike për këtë nuk e
19 di, mbase do t'ju jap përgjigje më vonë se tani për tani nuk
20 kam një përgjigje precize.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Një pyetje tjetër. A mund
22 të konfirmoni tani se nuk ka më materiale të rregullës
23 102(1)(b), për t'u nxjerrë?

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ka katër
25 materiale që janë objekte të të njëjtit vendim, të cilat në

1 një çështje tjetër, pra vendim për një çështje tjetër
2 gjyqësore, të cilat janë autorizuar për mos u nxjerrë.

3 Nuk i kemi nxjerrë këto, prandaj dhe do të kërkojmë
4 autorizim nga i nderuari Gjykatës, që të mos i nxjerrim këto
5 katër materiale deri sa të ekzistojnë arsyet pas këtyre masave
6 mbrojtëse.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përveç këtyre katër
8 materialeve, nuk ka materiale të tjera për t'u nxjerrë?

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, po e
10 konfirmoj këtë gjë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë e mbajta shënim.
12 Mbrojtja dëshiron të përmendë diçka?

13 Vetëm për materialin e rregullës 102(1)(b).

14 Zoti Aouini.

15 Z. AOUINI: [Përkthim] mirëdita i nderuar Gjykatës urimet
16 më të mira për vitin e ri të gjithëve.

17 Z. Gilissen do të bëjë parashtrime për nxjerrjen në
18 përgjithësi, por për këtë pikë në veçanti, mbase mund të
19 informoj, duke folur disi për historikun midis konferencës së
20 parë dhe të dytë për ecurinë e çështjes. Besoj se të nderuarit
21 Gjykatës i kujtohet se i kemi bërë kërkesë ZPS, që të nxjerrë
22 materialin audioviziv të intervistave me dëshmitarët. Dhe kemi
23 paraqitur dhe justifikimin përkatës dhe tani kemi arritur dy
24 dëshmitarë në përputhje me rregullën 102(1)(b).

25 Mbrëmë morëm korrespondencë nga ZPS-ja ku na shpjeguan se

1 po orvaten që të përmirësojnë transkriptimin e disa videove
2 për të kapërcyer disa prej vështirësive që përputhem me
3 justifikimet që ne u kemi paraqitur atyre kur u kemi kërkuar
4 videot.

5 Nuk kemi pasur kohën e mjaftueshme për ta parë vetë
6 nxjerrjen, mund të jenë dy prej tre materialeve që kolegu nga
7 ZPS-ja i përmendi dhe këto janë të rëndësishme që t'i themi
8 edhe për procesverbalin, sepse ne presim që t'i marrim këto
9 materiale audiovizive. Pra e kemi këtë kërkesë se mendojmë se
10 është shumë e rëndësishme që t'i marrim në gjuhën origjinale
11 sepse gjestet apo disa elemente të tjera të cilat nuk mund të
12 dalin në tekstin e zbardhur, pra në transkript, mund të duken
13 në këtë video.

14 Ne presim akoma që të marrim materialet e rregullës
15 102(1)(b), ta them më në përgjithësi, në mënyrë që të jenë më
16 të kënaqshme për ne. Pra për ta thënë në mënyrë të
17 përmbledhur, mund t'i kthehemi kësaj çështjeje përsëri, se
18 mund të kemi kërkesë për audio-video të dëshmitarëve të tjerë
19 dhe nëse nuk -- këto dy materiale që kemi marrë dje, nuk
20 zgjidhin kërkesën tonë të mëparshme mund t'ju drejtohem
21 përsëri. Por mund të ketë edhe disa materiale të tjera, që
22 mund të nxirren që nuk janë nxjerrë përpara.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Aouini.

24 Zoti Prokuror dëshironi që të shtoni diçka lidhur me këto
25 kërkesa të mundshme?

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Pra për të sqaruar materialet
2 që nxorëm dje nuk kanë lidhje me incizimin audioviziv që ka
3 kërkuar Mbrojtja. Në këtë moment, s'kam ç'të shtoj tjetër, Ka
4 pasur komunikime *inter partes* me Mbrojtjen, shpresojmë që t'i
5 vijojmë këto komunikime. Edhe kaq mund të them për këtë i
6 nderuar Gjykatës.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Prokuror.

8 Atëherë i ftoj palët që të vazhdojnë diskutimet *inter*
9 *partes* për këtë temë dhe të më drejtohen nëse nuk bien dakord
10 për këtë çështje. Dhe të më drejtohen sa më shpejt në mënyrë
11 që ta zgjidhim. Shpresoj që para të vijë konferenca e ardhshme
12 për shtyp [sipas përkthimit] të ketë përfunduar kjo gjë ose
13 përmes diskutimeve përmes palëve ose duke m'u drejtuar mua
14 palët.

15 Zoti Prokuror deshët të thoshit diçka?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Desha të shtoj se kur
17 thashë që e kemi përfunduar nxjerrjen sipas rregullës 102(1),
18 nuk do të nxjerrim materiale të reja më, se materialet e reja
19 kanë përfunduar. Por Mbrojtja ka kërkuar një sërë përkthimesh
20 që kanë të bëjnë me materialet e rregullës 102(1) dhe do t'ia
21 japim -- për të thënë kështu që ne po punojmë për t'i bërë
22 këto përkthime. Pra kur them që i kemi përfunduar, kjo do të
23 thotë dhe do nxirren të tjera si kjo, nuk do të thotë që
24 Mbrojtja nuk ka akses në to, po janë mbase përkthime të
25 regjistrimeve që janë nxjerrë përpara.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E mbajta shënim.

2 Të vazhdojmë me rendin e ditës për sot me nxjerrjen e
3 materialit provues me rëndësi për çështjen që është materiali
4 i rregullës 102(3).

5 ZPS-ja ka bërë të ditur në parashtrimet e veta se nuk e
6 ka kundërshtuar rëndësinë materiale të asnjë prej materialeve
7 të kërkuara ndaj njoftimit plotësues të rregullës 102(3).

8 ZPS-ja ka konfirmuar edhe se janë nxjerrë të gjitha
9 materialet e kërkuara nga njoftimi i rregullës 102(3) të cilat
10 nuk kanë nevojë për redaktime ose kanë nevojë vetëm për
11 redaktime standarde.

12 Mbrojtja në parashtrimet e veta ka vërejtur shqetësimet e
13 saja lidhur me mjaftueshmërinë e përshkrimit të materialeve që
14 ka në zotërim Prokuroria siç janë renditur në njoftimin e
15 rregullës 102(3) të Prokurorisë. Mbrojtja gjithashtu ka bërë
16 të ditur se do t'i kërkonte Prokurorisë t'a shqyrtonte
17 njoftimin plotësues të rregullës 102(3) dhe të jepte
18 informacione të tjera shtesë lidhur me materialet e renditura
19 aty.

20 Vërej se njoftimi plotësues i rregullës 102(3) i ZPS
21 është shpërndarë sot paradite dhe duhet të them se është një
22 njoftim plotësues i ri. Vërej faktin se materialet shtesë të
23 përfshira në njoftim nuk mund të renditeshin më parë për shkak
24 të kufizimeve që i vendos rregulla 107 dhe se për rrjedhojë
25 ZPS i kërkohet që të dorëzojë një njoftim plotësues.

1 Por në konferencën e tretë për ecurinë e çështjes, unë
2 konkretisht i bëra të ditur ZPS, se duhet që të kërkojë leje
3 para dorëzimit të një njoftimi plotësues të rregullës 102(3).
4 Pra i kujtoj edhe një herë ZPS, që nëse është nevoja të
5 kërkojë leje për ta plotësuar njoftimin e saj në të ardhmen.

6 Ju kërkoj palëve të më informojnë me zhvillimet më të
7 fundit lidhur me nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(3).
8 Në veçanti numrin e materialeve që mbeten për t'u nxjerrë nga
9 ZPS-ja dhe afatin e parashikuar për kryerjen e nxjerrjes; për
10 nevojën për plotësime të tjera të mundshme të njoftimit të
11 rregullës 102(3) në të ardhmen dhe për diskutimet *inter partes*
12 dhe nëse palët parashikojnë se si do t'i zgjidhin çështjet e
13 identifikuar nga Mbrojtja në parashtrimet e saj.

14 Zoti Prokuror keni fjalën.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit i nderuar
16 Gjykatës.

17 Më 5 dhe 25 nëntor të vitit 2021 ne kemi nxjerrë 837
18 dokumente të rregullës 102(3) të cilat ishin pjesë e kërkesave
19 të Mbrojtjes për 1017 dokumente. Në të njëjtën kohë ne e kemi
20 informuar Mbrojtjen për arsyet për nxjerrjen - pra që të
21 paraqesë arsyet pse e kërkon nxjerrjen e disa prej
22 materialeve. Asnjë prej tyre s'ka të bëjë me rëndësinë
23 materiale të këtyre.

24 Ne mendojmë se i kemi nxjerrë të gjitha materialet e
25 kërkuara, Mbrojtjes me përjashtim të atyre [për] të cilat u

1 kemi shpjeguar pse. Kështu që nuk kanë mbetur materiale për
2 t'u nxjerrë në këtë moment.

3 Sa i takon mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së
4 përshkimit të këtyre materialeve të rregullës 102(3), i
5 nderuar Gjykatës, vërej se lista e re dhe e përditësuar e
6 rregullës 102(3) përmban përshkrime të përditësuar, të
7 përmirësuar, më precize të këtyre materialeve. Por këto
8 përshkrime të përditësuar për procesverbal i janë njoftuar
9 *inter partes* Mbrojtjes më 22 tetor 2021. Pra, këto përshkrime
10 Mbrojtja i ka pasur në dispozicion që prej asaj date. Dhe tani
11 po e them zyrtarisht edhe për procesverbalin edhe i kemi
12 vendosur me dorëzimin e listës së rishikuar të rregullës
13 102(3).

14 Sa u takon komunikimeve *inter partes* të cilat vijojnë jo
15 vetëm në lidhje me nxjerrjen e materialeve dhe të rregullës
16 102(3) por edhe për nxjerrjen e materialeve më në përgjithësi,
17 më 23 dhjetor morëm një email shumë të dobishëm nga Mbrojtja,
18 ku bëhej një përmbledhje e problemeve që ende s'kishin marrë
19 zgjidhje. Ne dje i jemi përgjigjur këtij emaili duke i
20 vendosur për procesverbalin ato çështje që kishin mbetur pa
21 zgjidhur. Shpresojmë që do të jetë një pikënisje për
22 diskutimet e ardhshme me mbrojtjen.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Gilissen
24 keni fjalën.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

1 Konfirmojmë se nuk kemi dijeni për kundërshtimet që ka
2 ZPS-ja për materialitetin e materialeve që kemi përzgjedhur
3 nga njoftimi. Ne e kemi vërejtur qëndrimin e ZPS për këtë
4 çështje. Së pari kemi diskutuar për disa materiale me ZPS-në,
5 për të cilat ZPS-ja na ka dhënë shpjegim të mëtëjshëm -- për
6 përmbajtjen e disa materialeve dhe kjo ka çuar në nxjerrjen të
7 pjeshme apo të plotë të disa materialeve pa u bërë ndonjë
8 kundërshtim për rëndësinë materiale.

9 Sa i takon të dytës, është bërë nxjerrja e materialeve në
10 fjalë pa u bërë kundërshtim të rëndësisë materiale dhe pa u
11 bërë diskutim.

12 Dhe së treti, kemi bërë një diskutim për rëndësinë
13 materiale me ZPS-në, lidhur me disa materiale për të cilat nuk
14 jemi pajtuar dhe unë i qëndroj përzgjedhjes që ne i kemi bërë
15 këtyre materialeve. Se ne besojmë se materialet në fjalë kanë
16 rëndësi provuese për ne.

17 Ne nuk kemi parë pra, kundërshtim të rëndësisë materiale
18 dhe falënderojmë ZPS-në që ka vendosur të mos ta kundërshtojnë
19 rëndësinë materiale të këtij materiali, qartësisht provues
20 edhe me rëndësi për çështjen.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Gilissen.

22 Zoti Prokuror doni të shtoni diçka?

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo i nderuar Gjykatës asgjë për
24 këtë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Aouini, donit të

1 shtonit diçka?

2 Z. Gilissen e keni të ndezur mikrofonin.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Thjesht për
4 procesverbalin, për një element sa i takon asaj që kemi bërë
5 të ditur, kërkesat tona pra, për njoftimin. Thjesht për
6 procesverbalin dua t'a them që nëse do të ndodhë që në të
7 ardhmen do të hasim ndonjë problem për këtë në kërkesat tona,
8 në disa raste ne kemi bërë të qartë se çfarë është lloji i
9 përzgjedhjes të një dosjeje të plotë, çështje që mund të jetë
10 numri i referencës nga një vend tjetër ose diçka e tillë. Pra
11 kemi kërkuar që këto përshkrime nuk janë të plota, nuk janë
12 shteruese, nuk janë të dobishëm për ne. Prandaj ne duam që të
13 jetë, kemi kërkuar që të kemi të gjithë dokumentet lidhur me
14 dosjen gjyqësore, që besojmë që ka rëndësi për ne.

15 Kolegët e ZPS kanë bërë të ditur që ata do përpiqen të
16 bëjnë çmos dhe ndonjëherë edhe ata vetë marrin vetëm elementët
17 e këtyre dosjeve. Pra i marrim të copëtuara, nuk i marrim të
18 plota. Por thjesht për t'a thënë për procesverbalin, se mund
19 të ketë ndonjë element që ne mund ta kemi zbuluar më vonë dhe
20 ne e kërkojmë në tërësi këtë. Këtë desha të them.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Zoti Prokuror, doni të thoni diçka lidhur me këtë që sapo
23 u tha?

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo i nderuar Gjykatës nuk kemi
25 asgjë për të shtuar lidhur me këtë pikë. Vetëm thjesht diçka

1 tjetër në lidhje me nxjerrjen e materialeve të rregullës
2 102(3).

3 Ka edhe disa dokumente që ende nuk janë nxjerrë dhe të
4 cilat janë objekt i masave mbrojtëse që presin miratim prej
5 jush, i nderuar Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

7 Atëherë meqë nuk ka shoh ndonjë kërkesë prej palëve për
8 të marrë fjalën, atëherë të kalojmë te materialet e rregullës
9 102(3).

10 Në parashtrimet e veta me shkrim ZPS-ja ka bërë të ditur
11 se ka shënuar një farë progresi dhe ka rishikuar 30 për qind
12 dokumenteve të mbetura që përmenden në njoftimin e rregullës
13 102(3), të cilat mund të kenë përmbajta shfajësuese.

14 ZPS-ja ka bërë gjithashtu të ditur se ka në plan të
15 vijojë me një ritëm përafërsisht të njëjtë dhe me zellin e
16 njëjtë. [Ajo] përpigjet të nxjerrë sa më shpejt çdo dokument të
17 mbetur që bën pjesë në objektin e rregullës 103.

18 Përpara se t'ia jap fjalën Prokurorit, po i kujtoj edhe
19 një herë ZPS për detyrimin e vet që ka, të nxjerrë materiale
20 shfajësuese menjëherë dhe menjëherë sa i ka në kontrollin dhe
21 dijeninë e vet dhe vetëm për arsye të justifikueshme si p.sh.,
22 nevoja për redaktime të mëtejshme, një nxjerrje e tillë e
23 menjëhershme mund të arsyetohet.

24 Jam, sinqerisht t'ju them, pak i befasuar, që ZPS-ja
25 thotë se ka rishikuar vetëm 30 për qind të materialit të

1 rregullës 102(3) dhe se tani e ftoj ZPS-në që të shpjegojë se
2 pse nuk e ka përfunduar nxjerrjen e këtij materiali, meqë ky
3 është material bazë për Mbrojtjen dhe për përgatitjet e saj
4 për hetime.

5 Gjithashtu ftoj ZPS-në që të sqarojë nëse materiali që
6 është zbardhur mbrëmë, që është nxjerrë mbrëmë, përfshin edhe
7 materialet e përmendura në parashtrimet me shkrim dhe në qoftë
8 se Mbrojtja pret që të bëjë kërkesa të mëtejshme për masa
9 mbrojtëse, në lidhje me ato materiale.

10 Urdhëroni zoti Prokuror.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju faleminderit.

12 Nga dorëzimi i parashtrimeve kemi arritur një farë
13 progresi në lidhje me materialet potencialisht shfajësueses
14 dhe besoj që kemi arritur dikund në 50 për qind të rishikimit
15 të atij materiali. Dhe dokumentet që i kemi nxjerrë mbrëmë
16 ishin disa dokument shtesë që i gjetëm midis dy parashtrimeve
17 të ndryshme dhe bëhet fjalë për një numër të vogël dokumentesh
18 krahasuar me numrin e përgjithshëm të dokumenteve që kemi
19 rishikuar.

20 Do të vazhdojmë me ritmin e njëjtë, pra sa më shpejt që
21 është e mundur që të bëjmë këtë rishikim dhe besoj që nuk do
22 të na duhet edhe shumë kohë. Kemi identifikuar siç thashë një
23 numër të vogël dokumentesh deri tani por do të vazhdojmë siç
24 thashë edhe një herë me një ritëm të shpejtë të rishikimit të
25 dokumenteve në mënyrë që të bëjmë nxjerrjen e tyre sa më

1 shpejt që është e mundur.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju thoni, pra, se besoni se
3 nuk do t'ju duhet shumë kohë dhe se do të punoni me një ritëm
4 shumë të shpejtë.

5 Atëherë do t'ju pyes për afatin, pra në vend të fjalës
6 "sa më shpejt që është e mundur" ose "aq më mirë që mundemi",
7 atëherë na thoni një kohë reale. Nëse e bëj unë vetë
8 matematikën, ju keni rishikuar 80 për qind të këtyre
9 dokumenteve përpara parashtrimeve që keni bërë në fillim të
10 kësaj jave, që do të thotë brenda 3 ditësh ju keni bërë 20 për
11 qind. Sipas formulës matematikore për të mbërritur në 50 për
12 qind duhet pra, ta shumëzohet këtë me 2.5 or 3 dhe kështu me
13 radhë.

14 Kështu që mbas këtij kalkulimi atëherë do të na duhen
15 edhe dy javë apo jo?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, varet nga
17 numri i dokumenteve. Ka disa dokumente që kanë me qindra faqe.
18 Të paktën disa prej tyre janë me qindra faqe.

19 Por ne do të vazhdojmë të bëjmë më të mirën tonë që t'i
20 rishikojmë këto rishikime dokumentesh brenda afatit që keni
21 parashikuar ju.

22 Në fakt, i nderuar Gjykatës ka disa afate të njëkohshme
23 këtë muaj me vetë afatin e parashtrimit të dosjes paraprake
24 dhe të tabelës sipas rregullës 109, që duhet të dorëzohet
25 menjëherë më pas. Por besoj që një afat prej tre apo katër

1 javësh do të jetë më se i mjaftueshëm.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë a pajtoheni se
3 është arsyeshme të mendoj që brenda tre apo katër javësh do të
4 përfundoni punën dhe se është afati maksimal që mund të jepet
5 për konferencën e ardhshme.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po ashtu është. Ju
7 faleminderit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

9 Zoti Gilissen.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kam disa parashtime në lidhje me
11 materialin shfajësues, por me gjithë respektin, dua që këto
12 pika t'i trajtoj së bashku kur të trajtojmë elementet që janë
13 të renditura në pikën (e) të urdhrit tuaj.

14 Propozoj që t'i bëj parashtimet e mia atëherë në mënyrë
15 që t'i paraqes ato në mënyrë më gjithëpërfshirëse.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Atëherë edhe
17 një herë do të theksoj se më të përfunduar nxjerrja e
18 materialit shfajësues, Mbrojtja mund të përgatitet siç duhet,
19 t'i bëjë paraqitjet e veta për paraqitjen e çështjes të
20 provave të veta.

21 Tani të kalojmë tek materiali i rregullës 107. Nga
22 parashtimet e veta me shkrim, ZPS-ja bën të ditur se ka marrë
23 autorizim nga dhënësit e informacionit për një numër shtesë
24 dokumentesh në përputhjes me ato kufizimet e rregullës 107.

25 Tani ZPS-ja pret autorizime të tilla në lidhje me një

1 numër të vogël dokumentesh. Unë do t'i kërkoj Prokurorit të na
2 paraqesë pak më shumë hollësi në lidhje me këto materiale.

3 Urdhëroni zoti Prokuror.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po i nderuar Gjykatës. Ne kemi
5 shtuar edhe përfshirë edhe shtatë dokumente të tjera në listën
6 e rregullës 102(3) për të cilat duhet autorizim. Ndoshta ka
7 edhe dy herë më shumë prej atyre dokumenteve për të cilat
8 duhet autorizim.

9 Tani është e vështirë të caktohet një afat kur është
10 fjala për diskutime që duhet të zhvillohen me dhënësit e
11 informacionit sepse është një diskutim i dyanshëm. Por për
12 momentin nuk mund t'ju jap një afat specifik konkret. Mund
13 t'ju them vetëm 10-15 dokumente dhe se jemi në diskutime, në
14 bisedime me dhënësit e informacionit dhe se do të kërkojmë
15 leje për dorëzimin enjë liste të përditësuar të rregullës
16 102(3) menjëherë sa të marrim autorizimin në lidhje me ato
17 dokumente.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Prokuror.

19 Zoti Gilissen ose Aouini, në lidhje me dokumentet e
20 rregullës 107.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju faleminderit.

22 Ne e kemi marrë këtë njoftim të famshëm. Padyshim që do
23 të na duhet kohë për ta parë këtë listë, për ta analizuar atë
24 dhe do të bëjmë pastaj përzgjedhjen e dokumenteve dhe besoj që
25 do të mund t'ju japim më shumë informacion gjatë konferencës

1 së ardhshme për ecurinë e çështjes.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara se të kalojmë te
3 përkthimet atëherë do t'i pyes palët në qoftë se në
4 përgjithësi po përballohen me vështirësi në procesin e
5 nxjerrjeve të materialeve.

6 Mendoj se zoti Gilissen kishte disa komente me këtë. Por
7 para se t'i kthehem Mbrojtjes, zoti Prokuror a keni ju ndonjë
8 gjë për të shtuar përveç asaj që thatë deri tani?

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo nuk kam i nderuar Gjykatës.
10 Faleminderit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Gilissen urdhëroni.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Me gjithë respektin
13 për ju zoti Kryetar, ju keni pikën (d) përpara, rreth
14 rregullës 95(2).

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po. Mund t'i paraqitni
16 parashtrimet tuaja për të dy pikat.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju faleminderit. Ne presim ZPS-në
18 që të fillojë me identifikimin e materialit provues që do të
19 jetë objekt i kundërshtimeve të mundshme për provueshmërinë
20 nga pikëpamja e Mbrojtjes.

21 Besoj që kur ta marrim nxjerrjen, kur të na nxirren të
22 gjitha materialet dhe vetë dosja paraprake si edhe tabela e
23 ZPS, atëherë do të jemi në një pozitë për t'i analizuar të
24 gjitha dokumentet në tërësinë dhe plotësinë e tyre.

25 Pika e dytë lidhet me rregullën 102(3). Siç e dini, kjo

1 ka të bëjë me një njoftim në lidhje me dokumentet që i ka në
2 posedim ZPS-ja dhe dokumentet që ZPS-ja nuk ka ndërmend t'i
3 përdorë gjatë gjykimit. Ne kemi marrë njoftimin e ZPS në kohën
4 e duhur lidhur me këtë, mirëpo pas diskutimeve me ZPS-në
5 mendojmë që të gjejmë një zgjidhje të përbashkët.

6 Jemi duke folur këtu për rreth 1200 ose 1100 dokumente
7 dhe na duhet ndihma e ZPS për të identifikuar se çfarë janë
8 këto dokumente, sepse ndonjëherë përshkrimet janë shumë të
9 vogla dhe nuk flasin shumë. Janë të pamjaftueshme.

10 Kemi marrë disa grupe dokumentesh kemi marrë një grup
11 prej 400 dokumentesh apo paketë prej 400 dokumentesh, ku kemi
12 parë që ka 96 materiale shfajësuese. Dhe në fakt këtë e kemi
13 parë edhe në paketën e nxjerrë në bazë të rregullës 102(3).

14 Mendoj se është detyra dhe detyrimi i ZPS që të rishikojë
15 dhe t'i nxjerrë të gjitha materialet shfajësuese që i ka në
16 zotërim të vetin dhe fatkeqësisht ky detyrim nuk është
17 plotësuar, nuk është bërë siç duhet nga ana e ZPS. Ne kemi
18 marrë 96 dokumente shfajësuese, pra si material shfajësues
19 pasi që i kemi përzgjedhur ato nga lista e njoftimit të
20 rregullës 102(3).

21 E përdora fjalën "pas përzgjedhjes së dokumenteve nga ana
22 jonë" - por është ndoshta është pak si fjalë e ashpër për t'a
23 thënë. Ndoshta fjala "për arsye se ne përzgjodhëm dokumentet e
24 rregullës 102(3) të njoftimit të rregullës 102(3)" do të ishte
25 më me vend. Unë nuk dua të nxjerr përfundime sepse nuk do të

1 ishte mirë për përfaqësimin.

2 Por dua të theksoj se duhet të përqendrohemi në
3 përfundimet a mund t'i besojmë plotësisht ZPS që do ta nxjerrë
4 materialin shfajësues, në pajtim me detyrimin vet. Unë nuk kam
5 nevojë t'ju përkujtoj. Ju thoni nxjerrje e menjëhershme dhe e
6 vazhdueshme e materialit shfajësues.

7 Ky nuk është sulm prej anës tonë drejtuar ZPS. Sigurisht
8 që dua ta nënvizoj këtë se nuk është ky një sulm i joni. Është
9 vetëm një deklaratë alarmante.

10 Në parashtrimin e djeshëm dhe me faktin që aty përmendet
11 se ZPS-ja ka rishikuar vetëm 30 për qind të materialeve ky
12 është një fakt alarmues.

13 Çështja e dytë ka bërë me një çështje që lidhet me të
14 parën. Lidhet faktikisht me nxjerrjen e këtyre njoftimeve nga
15 ana e ZPS. Do të përqendrohem në disa probleme që kemi hasur
16 gjatë rishikimit të këtyre dokumenteve.

17 Pas leximit të analizës së materialit të nxjerrë, ne kemi
18 gjetur në mesin e atyre materialeve dhe përshkrime cilësore
19 të shumë prej tyre, por edhe jo adekuate apo të pamjaftueshme,
20 prej të cilave nuk mund të kuptosh në mënyrë të arsyeshme
21 përmbajtjen e dokumenteve.

22 Për shembull, do tju jap si shembull një dokument me
23 numrin e provës ERN SIT00375011-00375014.

24 Në përshkrimin e këtij dokumenti thuhet që është DVD dhe
25 përmendet një datë dhe është vetëm një rishikim i një

1 dokumenti që ne e kemi zgjedhur dhe mbas atij rishikimi e kemi
2 parë që ky dokument ka të bëjë me një dëshmitar në një
3 çështje. Dhe kur shoh raste të këtilla, të përshkrimeve të
4 pamjaftueshme, mendoj që duhet t'ua tërheq vëmendjen sepse një
5 informacion si ky duhet të përfshihet në përshkrimin e
6 dokumentit në fjalë, në një njoftim.

7 Në njoftimin në përshkrime të tjera nuk kemi pasur ndonjë
8 problem, por mund të ndodhë që të humbin ndonjë informacion
9 nga ajo që nuk dimë se çfarë përfshihet në atë dokument.

10 Në kushte të tilla, sa dokumente interesante, të
11 rëndësishme e relevante apo shfajësuese në fakt mund t'i
12 humbim apo i kemi humbur? Kjo është pyetja që parashtrohet kur
13 merremi me trajtimin e këtyre çështjeve.

14 Shembulli i dytë. Dhe unë e konsideroj mjaft të
15 rëndësishme edhe pse mund të jetë diçka me të cilën
16 ballafaqohemi shumë prej nesh. Është dokumenti me numrin ERN
17 091275-091387. Përshkrimi i këtij dokument ishte thjesht një
18 numër reference dhe nuk kishte kurrfarë përshkrimi tjetër.

19 I kërkuam ZPS që ta përmirësonte, ta plotësonte
20 përshkrimin dhe meqë bashkëpunojmë morëm përgjigje. Morëm një
21 përshkrim të ri ku u përfshi një hollësi një detaj shumë i ri,
22 se ky dokument i referohet një personi të interesit të madh.

23 Pra ishte fati jonë që kërkuam, na bënë një përshkrim më
24 të plotë të dokumentit të përzgjedhur, sepse tema e këtij
25 dokumenti ishte e një rëndësie të madhe. Kjo temë gjithsesi

1 duhet të përmendet në përshkrimin e këtij dokumenti sepse
2 mospërfshirja e kësaj të dhëne i shkakton padrejtësi
3 Mbrojtjes.

4 Dhe një çështje e tretë që lidhet me dy të parat. Janë
5 edhe disa materiale të tjera të cilat nuk janë përfshirë në
6 njoftimin e ZPS. Mund të japim një shembull të kësaj. Kemi
7 marrë për shembull një dokument ku përmendet një dokument
8 tjetër relevant dhe ai dokument vetë nuk është përfshirë në
9 njoftim. Edhe pse ai dokument është shumë i rëndësishëm për
10 Mbrojtjen.

11 Nuk ka nevojë të hyj në hollësi të mëtejshme sepse jemi
12 në seancë publike dhe nuk e shoh të arsyeshme të kalojmë në
13 seancë të mbyllur, thjesht po e them këtë për hir të
14 procesverbalit sepse këtë e diskutojmë edhe me të tjerë ndër
15 të tjera edhe me ZPS-në.

16 Pas gjithë kësaj që e thashë nuk mund të presim thjesht
17 që të kemi fatin dhe të zgjedhim dokumentin e duhur apo
18 materialin e duhur.

19 Pra, duam që para jush të parashtrojmë nevojën që ZPS-ja
20 t'a rishikojë edhe një herë këtë listën e njoftimit të vet të
21 rregullës 102(3), për sa i përket përshkrimit të nevojshëm dhe
22 gjithë - të plotë, në mënyrë që t'a përfundojë në mënyrë të
23 efektshme dhe me efikasitet detyrimin e vet të nxjerrjes të të
24 gjithave materialeve që i duhen ;brojtjes, sidomos duke marrë
25 parasysh faktin se gjatë rishikimit që po bëjmë ne, po gjejmë

1 dokumente që nuk janë përfshirë në njoftim apo që janë të
2 përfshira në mënyrë të papërshtatshme apo të pamjaftueshme.

3 Me këtë Mbrojtja përballet me rrezikun që të mos gjejë
4 dokumentet që i duhen dhe që i gjykon të rëndësishme, për
5 shkak të këtyre mungesave në përshkrim. Prandaj, njoftimi i
6 ZPS duhet të vazhdojë të jetë i hapur për Mbrojtjen. Kjo do të
7 thotë që Mbrojtja duhet të ketë të drejtën që të përzgjedhë
8 dokumente nga ky njoftim. Dhe ky përfundim që po jap unë nuk
9 është thjesht një dëshirë, po është rezultat i një praktike që
10 kemi ndjekur gjatë shtatë muajve të fundit.

11 Ky përfundim është rezultat i realitetit të këtyre
12 procedurave. Siç e dini i nderuar Gjykatës mbasi kemi
13 përfunduar të gjitha përzgjedhjet e dokumenteve në njoftim dhe
14 përpara konferencës së fundit për ecurinë e çështje, thjesht
15 një natë përpara morëm një nxjerrje materialesh që përmbante
16 dokumente shumë të rëndësishme në lidhje me disa procedura
17 interesante dhe shumë të rëndësishme në lidhje me një person
18 interesant dhe shumë të rëndësishëm.

19 Pra, duhet t'ju shmangemi situatave të këtilla dhe
20 prandaj tema e dokumenteve që do të nxirren në të ardhmen do
21 të vazhdojë të jetë e rëndësisë së madhe për Mbrojtjen. Dhe
22 ekzistojnë arsye që t'i kthehemi edhe një herë kësaj pike
23 mbasi t'i kemi marrë të gjitha nxjerrjet e dokumenteve prej
24 ZPS, në lidhje me të gjitha elementet që lidhen me këtë temë.

25 Edhe një herë, ju falënderoj që pranuat këto parashtime

1 të mia në procesverbal. Nuk do të vazhdoj më në lidhje me këtë
2 pikë në këtë moment i nderuar Gjykatës. Thjesht edhe një herë
3 do të theksoj se ZPS-ja duhet ta rishikojë edhe një herë se sa
4 e ka kompletuar njoftimin e vet, se sa i ka përshkrimet e veta
5 gjithëpërfshirëse dhe të bëra në mënyrën e duhur dhe kjo është
6 në interesin e të gjithëve për mendimin tim. Dhe duhet të
7 kuptohet si një mundësi pozitive për të gjithë ne.

8 Ne kemi një Prokuror në këtë çështje. Kështu është. Dhe
9 të gjithë së bashku do të mund të që t'i vëmë në lëvizje dhe
10 t'i përmirësojmë gjërat për mendimin tim.

11 Zoti Kryetar, mendoj që nuk ka nevojë të jem edhe më i
12 plotë. Mendoj që e kuptuat këtë shumë mirë se çfarë desha të
13 them. Jam i gatshëm t'ju përgjigjem pyetjeve. Por e di që nuk
14 parapëlqeni që të futemi në seancë të mbyllur dhe ne nuk e
15 bëjmë këtë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Gilissen.

17 Ju ngritët dy çështje. E para çështja e shqyrtimit të
18 materialeve shfajësuese dhe sipas rregullës 102(3). Këtë e
19 përmenda para pak minutash. Kjo është një çështje që duhet të
20 ketë afat, duhet të bëhet urgjentisht. Janë shumë vonë me
21 procesin. Dhe kemi bërë një diskutim me Prokurorinë që
22 Prokuroria duhet të angazhohet ta bëjë deri mbas dy javësh ose
23 më e shumta mbas tre-katër javësh. Dhe çështja tjetër që
24 ngritët ju janë hollësitë në përshkrimin e secilit dokument në
25 njoftim. Kjo është një çështje që është diskutuar edhe në

1 çështje të tjera gjyqësore. Do t'ja jap fjalën Prokuroria por
2 dua të bëj edhe një pyetje tjetër për Prokurorin. A e shikoni
3 mundësinë për të shtuar hollësi më specifike në njoftim mbas
4 shembujve që u dhanë nga Mbrojtja apo e mendoni që njoftimi
5 vetë është i qartë dhe nuk shikoni arsye për ta plotësuar atë?

6 E bëj këtë pyetje sepse mendoj që ne duhet të paktën t'a
7 kemi një ide të qartë sot nëse ka mosmarrëveshje midis palëve
8 në lidhje me këtë. Se në qoftë se ka mosmarrëveshje duhet kjo
9 çështje të parashtrohet para Gjykatës, nuk mund ta lemë në
10 fund të fazës paraprake, duhet të zgjidhet më përpara.

11 Prokuror keni fjalën.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,
13 faleminderit.

14 E kemi diskutuar tashmë çështjen e nxjerrjes së
15 materialeve në bazë të rregullës 102(3).

16 Në lidhje me përshkrimet në listën sipas rregullës
17 102(3), ne kemi dhënë përshkrimet e përditësuara në tetor. Dhe
18 nëse Mbrojtja i quan të papranueshme apo të pamjaftueshme disa
19 prej tyre, mund të na e thonë dhe ne me shumë kënaqësi do t'i
20 japim përshkrimet që kërkojnë, nëse duhen dhënë përshkrime të
21 tjera. Por ne jemi kundër dorëzimit të një liste të re sipas
22 rregullës 102(3) sepse mendojmë që në përgjithësi, përshkrimet
23 aty janë të mjaftueshme.

24 Unë nuk kam kundërshtim për faktin që përmendi Mbrojtja
25 që disa nga dokumentet nuk janë të përshkruar shtu siç duhet

1 dhe i kërkojmë Mbrojtjes që të na i thonë se cilat janë këto
2 dokumente dhe ne mund t'i japim përshkrimet e mëtejshme.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Prokuror.

4 Nga ajo që ju thatë tani pra, ju po ftoni Mbrojtjen që të
5 dërgojë listën e dokument apo të provave për të cilat kërkojnë
6 më shumë hollësi.

7 A është zgjidhje e kënaqshme kjo për Mbrojtjen për atë
8 çfarë kërkon Mbrojtja?

9 Zoti Aouini.

10 Z. AOUBINI: [Përkthim] Desha të them që ky është detyrim i
11 ZPS. Ne e kemi bërë detyrën tonë. Ne i kemi vazhduar
12 diskutimet tona. Ne kemi kërkuar përshkrime për rreth 1500
13 dokumente për të cilat përshkrimi që kanë dhënë ata është
14 krejtësisht i papërdorshëm i padobishëm dhe dhënia e disa
15 numrave që na kanë bërë ta nuk na tregon nëse këto dokumente
16 janë të dobishme për ne apo jo.

17 Çështja kryesore është që afati po afrohet, afati i
18 përfundimit po afrohet dhe ne ende po marrim dokumente dhe
19 shohim që kur shohim përmbajtjen e dokumenteve, përshkrimi i
20 tyre nuk është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm edhe pas
21 përditësimit që janë bërë. Dhe kjo thyen atë, apo shkel atë
22 elementin e besimit që duhet të kemi ne. Kjo është çështje
23 kryesore. Dhe duke qenë se ZPS-ja po rishikon materialin
24 shfajësues apo çfarëdo rishikimi që po bën, përshkrimet e
25 sakta të tyre janë të dobishme për Mbrojtjen.

1 Pjesa tjetër është që në qoftë se lihet hapur njoftimi,
2 atëherë ne do të kemi mundësi si Mbrojtje të identifikojmë
3 disa dokumente dhe të shikojmë nëse mund të shkojmë aty
4 përsëri te njoftimi dhe a mund ta gjemë aty dhe në vartësi të
5 atij numri.

6 Pra, mund të themi që ky numër i caktuar është relevant
7 apo jo. Përndryshe ne nuk do të jemi në gjendje të ushtrojmë
8 të drejtën për të thënë se çfarë është relevante për ne. Ne
9 nuk duam t'a ngarkojmë këtë proces më shumë sesa duhet, por
10 nuk duhet pastaj të dalim para një gjykatësi për të debatuar
11 këtë çështje më vonë sepse nuk duhet që mbas disa muajsh ne të
12 shohim një dokument apo një provë dhe të themi që "jo këtë nuk
13 duhet ta kishim humbur apo mos ta kishim parë". Pra këtë po
14 përpigemi të bëjmë me materialet shfajësuese.

15 Sigurisht ekziston çështja e kohës por duhet të vihet në
16 procesverbal se çfarë qasje duhet përdorur për materialet
17 shfajësuese. Ne kemi bërë shumë diskutime me Prokurorinë. Kjo
18 ka qenë me dobi për rëndësinë materiale të asaj që është
19 shfajësuese.

20 Ne besojmë që ekziston -- në qoftë se ke një burim ose
21 një lidhje me dokumentin që ka rëndësi për ne, qasja që duhet
22 të ndjekë Prokuroria është ajo që konteksti duhet të jetë
23 shfajësues dhe sfondi i përgjithshëm duhet të jetë i
24 kuptueshëm për ne. Ne duhet të biem dakord për të dhe duhet të
25 kemi qasjen më të gjerë të mundshme për të përcaktuar se çfarë

1 është shfajësuese sepse ata nuk mund të vendosin për ne se
2 çfarë mbrojtje do të bëjmë, se cilat janë personat me interes
3 për ne apo jo.

4 Disa nga dokumentet ende nuk janë në listë dhe duhet të
5 jenë aty dhe kjo është një pjesë e arsyes pse jemi përfshirë
6 në këtë diskutime dhe po përpiqemi të përcaktojmë pozicionin e
7 secilës palë.

8 Kjo është një qasje konstruktive për të mos çorientuar
9 asnjë palë, të mos keqdrejtohem apo të çorientojmë palën
10 tjetër dhe që të gjejmë zgjidhje të përbashkët.

11 Këto ishin ato që desha të ngre.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Gilissen.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kam diçka shtesë për të thënë që
14 është e rëndësishme. Unë nuk dua të detyrohem të zgjedh të
15 gjitha dokumentet në njoftim. Dhe kam mendimin që në qoftë se
16 do të vazhdojë ashtu, unë do të detyrohem që ta bëj këtë vetëm
17 për të shmangur një situatë të tillë që mos të kemi qasje në
18 një dokument të rëndësishëm apo informacion të rëndësishëm.
19 Pra, ky është qëllimi i kësaj që po them. Faleminderit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në pyetje vijuese për
21 Mbrojtjen.

22 A i keni përfunduar dokumentet që keni zgjedhur në
23 njoftim sepse afatet që kam përcaktuar më përpara për nëntorin
24 dhe dhjetorin, nëse nuk gaboj, e kishin tejkaluar afatin
25 paraprak. Pra ju po kërkoni shtyrje të afatit apo çfarë?

1 Sepse kemi dy debate në të njëjtën kohë. Debatin për
2 afatet kohore apo kalendarin dhe debatin se si duhet të jetë
3 lista. Unë e kuptoj se këto janë të lidhura me njëra-tjetrën,
4 sepse në qoftë se përshkrimet nuk janë të mjaftueshme atëherë
5 ju nuk mund t'i zgjidhni dokumentet në mënyrën e duhur por do
6 t'ju duhet një vendim nga Gjykatësi për këtë dhe vendimi duhet
7 të jepet para sesa të përfundojë afati.

8 Zoti Aouini.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Do t'i shpjegoj gjërat sa më shpjet
10 që të jetë e mundur.

11 Afatet kanë kaluar. Ne i kemi bërë zgjedhjet tona. Ne i
12 kemi kërkuar përshkrimet. I kemi marrë ato dhe jemi përpjekur
13 që t'i përmbahemi afateve. Po problemi është që ne po kuptojmë
14 që kur e shikojmë përmbajtjen, përshkrimet megjithëse janë
15 përmirësuar përsëri janë të pamjaftueshme për Mbrojtjen. Kjo
16 është një pjesë e problemit.

17 Kemi edhe tani njoftimin shtesë. Dhe ne po kërkojmë që të
18 rishikohet edhe një herë për t'a plotësuar, për të parë nëse
19 ka dokumente që mungojnë dhe për të bërë përshkrime më të
20 mira. Në mënyrë që në qoftë se do të marrim një njoftim tjetër
21 për të cilin do të kemi një mundësi më të mirë në bazë të
22 përshkimeve më të qarta që do të bëhen, ne mund të bëjmë
23 zgjedhje më të mirë. Kjo është e lidhur me pjesën e parë sepse
24 siç e tha zoti Gilissen, nuk ka arsye që të kemi ne afate për
25 të zgjedhur dokumentet sepse ajo që mendojmë se është me

1 rëndësi materiale sot, mund të jetë e lidhur me diçka tjetër
2 që mund të marrim mbas disa muajsh.

3 Zoti Gilissen ngriti një çështje apo dha një shembull
4 shumë të rëndësishëm për një temë që ne e zbuluam mbasi kishte
5 kaluar afati. Dhe patëm fat dhe ne nuk duhet të bazohemi te
6 fati për zgjedhjen e dokumenteve. Ne patëm fatin që e zgjodhëm
7 atë dokument, atë provë, por ndoshta mund të ketë dokumente të
8 tjera në një njoftim që lidhen me të. Ne duhet të eksplorojmë
9 çdo gjë dhe të kemi qasje në çdo gjë që lidhet me këtë temë.

10 Pra nuk duhet të ketë pengesë Mbrojtja që të zgjedhim
11 dokumentet e veta pasi të jetë caktuar afati. Pra njoftimi
12 duhet të jetë i hapur sepse ne nuk mund të jemi të sigurt 100
13 për qind në bazë të përshkrimeve. Dhe ka disa dokumente të
14 tjera apo informacione të tjera që mund të dalin më vonë gjatë
15 çështjes. Pavarësisht se sa me zell punojmë ne, ato mund të
16 dalin më vonë.

17 Pra zgjidhja do të ishte që të punojmë në mënyrë
18 konstruktive së bashku me ZPS-në për të zgjidhur çdo gjë nga
19 njoftimi. P.sh., të jap një shembull, zoti Shala e ka mbiemrin
20 Shala, por Shala është edhe emri i një krahine. Ajo ne nuk na
21 vlen. Pra duhet të gjejmë një zgjidhje së bashku në mënyrë që
22 ne të mos humbin informacione të rëndësishme.

23 Pra të kemi përshkrime më të mira dhe të kemi një afat të
24 hapur.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit zoti Aouini.

1 Zoti Prokuror.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë i dëgjova me vëmendje
3 ankesat e Mbrojtjes që u paraqitën tani dhe pozicioni jonë
4 mbetet që ne kemi dhënë përshkrime të përmirësuara që në
5 tetor, që më 25 tetor dhe besojmë që në përgjithësi këto
6 përshkrime janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

7 Por ndoshta ka edhe disa përshkrime që nuk janë të
8 mjaftueshme dhe të përshtatshme të cilat mund të na vihen në
9 dukje. Por ne jemi kundër kërkesës që të rishikojmë edhe një
10 herë të gjithë njoftimin dhe listën sipas rregullës 102(3).

11 Ne jemi të mendimit se shumica e dokumenteve janë me
12 përshkrime të mjaftueshme. Kur vjen puna te dokumentet që
13 mungojmë, Mbrojtja përsëri mund të na kontaktojë, sepse një
14 nga arsyet që dokumentet mund të mos jenë të listuara është
15 sepse nuk e kemi atë dokument. Nuk e di tani këtu po
16 hamendësoj, por p.sh., mund të mos e kemi atë dokument në
17 zyrat tona. Këto janë përgjigjet.

18 Këto janë përgjigjet tona ndaj parashtrimeve të Mbrojtjes
19 i nderuar Gjykatës.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ka ndonjë gjë për të shtuar
21 nga Mbrojtja?

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne po
23 përpiqemi - besoj e kuptoni se ne po e bëjmë këtë për të
24 shmangur një katastrofë. Ne nuk duam që të zbulojmë një
25 dokument që nuk është përshkruar ashtu siç duhet mbas nja dy

1 apo tre apo gjashtë muajsh. Ky është i vetmi qëllim. Nuk është
2 për të fituar kohë apo ndonjë gjë të tillë. Prandaj kërkojmë
3 që për ta shmangur këtë mundësi të gjithë dokumentet në listën
4 e njoftimit të jenë të shkruara mirë dhe duam të gjejmë një
5 zgjidhje dhe për t'a gjetur këtë zgjidhje duhet të mbahet e
6 hapur lista për është gjithë ne.

7 Megjithatë, i nderuar Gjykatës ju duhet të vendosni.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Rezultati i asaj që kërkon
9 ju zoti Gilissen është që të pezullohen të gjitha afatet për
10 komunikimin dhe nxjerrjen e materialeve provuese sipas
11 rregullës 102(3). Pra, ju do të vazhdoni diskutimet, *inter*
12 *partes* dhe kërkon që të mos ketë afate për dokumentet shtesë.

13 Problemi me këtë është që nuk ka afat, mund të zgjasë
14 gjashtë muaj, tetë muaj, dhjetë muaj. Unë si Gjykatës nuk mund
15 ta lë këtë pa afat. Nuk mund ta bëj këtë. Nuk është e mundur
16 sepse në qoftë se e bëj këtë atëherë ju nuk do bënit punën
17 tuaj të hetimeve sepse nuk do t'i keni materialet shfajësuese.

18 Unë e kuptoj që ju po përpiqeni të gjeni zgjidhje
19 pragmatike, për këtë çështje. Por nga ana tjetër më duhet
20 shumë e komplikuar që t'i pezulloj të gjitha afatet për këtë
21 lloj materiali, të materialit shfajësues. Ka dy gjëra këtu dhe
22 për njoftimin e përditësuar sipas rregullës 102(3) të fundit
23 që është protokolluar dhe për dokumentet e reja.

24 Por për ato që është bërë njoftim në tetor, ka disa prej
25 tyre për të cilat kërkon informacion, ju ose do të merrni

1 dokumentin ose më shumë informacion në shkrim për të vendosur
2 nëse është me interes për ju ose jo. Kjo është logjike. Por
3 dokumentet që nuk i keni kërkuar - për të cilat s'keni kërkuar
4 as plotësimin e përshkrimit as vetë dokumentin, a është
5 problem, a janë problem ato?

6 Nuk e kam të qartë. A po thoni që "në rregull, problemi
7 ynë është vetëm me ato dokumente për të cilat kemi kërkuar
8 hollësi të mëtejshme?", apo është që edhe këto dokument të
9 cilat nuk i keni kërkuar, nuk jeni të sigurt se pse nuk keni
10 informacion të mjaftueshëm? Dhe për këto ju keni pasur afat
11 për t'i kërkuar këto dokumente. Ju nuk i keni kërkuar *inter*
12 *partes* ZPS që të ofronin shpjegime të mëtejshme, përshkrime të
13 mëtejshme dhe në qoftë se ata nuk do ta bënin këtë, duhet të
14 kishit ardhur tek unë ta kërkonit.

15 E shikoni ku e kam fjalën. Sepse ju kishit një afat për
16 këtë. Për të kërkuar përshkrime të mëtejshme nga ZPS-ja por ju
17 nuk i keni kërkuar.

18 Zoti Aouini.

19 Z. AOUBINI: [Përkthim] Ndoshta nuk u shpreha qartë.
20 Dokumentet për të cilat nuk kemi kërkuar përshkrime, nuk i
21 kemi zgjedhur për t'i parë. Dhe këto i kemi parë mbasi ishte
22 mbyllur afati i njoftimit.

23 Çështja është se në qoftë se zbulojmë sot një temë të re,
24 një numër reference të ri, diçka të re dhe e shohim që disa
25 prej dokumenteve që lidhen me këtë çështje apo me këtë temë,

1 apo me këtë person është tek ai njoftim por ne nuk e kemi parë
2 atë, atëherë nuk lejohemi ne që ta shikojmë këtë dokument? Kjo
3 është çështja kryesore, prandaj edhe desha të jem i hapur.
4 Sepse nuk janë vetëm 15 dokumente në njoftimit edhe të
5 zgjedhim prej tyre. Mund të ketë emra personash, vende, tema
6 të cilët mund të lidhen me dokumente të tjera dhe prandaj i
7 kthehem njoftimit. Ne nuk po kërkojmë që të mbahet krejt i
8 hapur procesi i dhënies së njoftimit.

9 Ndoshta mund të vihet një afat për një numër dokumentesh
10 të caktuar dhe pastaj për një numër dokumentesh të tjerë sepse
11 ato që nuk i dimë, nuk i dimë. Nuk e di se çfarë nuk ke parë
12 në qoftë se nuk e ke parë. Dhe mund të zbulosh nga burime të
13 tjera që ka një informacion tjetër që lidhet me ato dy tema të
14 caktuara që mund të ketë lidhje për ne. Dhe kjo mund të jetë
15 edhe pavarësisht nga njoftimi. Ne po e bëjmë atë. Na jepni çdo
16 gjë që keni në lidhje me këtë temë, nëse është në listë apo,
17 nëse është në njoftim apo jo. Kjo mund të jetë një zgjidhje e
18 pranueshme për të gjithë.

19 Ne e kuptojmë që kjo mund të vazhdojë pafundësisht në
20 qoftë se lihet ashtu, por duhet Mbrojtjes t'i jepet mundësia
21 që të ketë qasje në çdo gjë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Aouini.
23 [Kjo është] Shumë e dobishme sepse nga ajo që thoni ju, nuk e
24 keni fjalën për të gjitha materialet e listës por flisni nëse,
25 në rastin hipotetik, do të vinheshit në dijeni të një fakti të

1 ri përmes nxjerrjes së materialit shfajësues, nuk do të
2 pengoheshit nga mundësia për t'a kërkuar dokumentin që aso
3 kohe nuk e dinit që do të ishte me rëndësi materiale për
4 përgatitjen e mbrojtës. Këtë e kuptoj.

5 Zoti Prokuror...

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Zoti Kryetar, kërkoj fjalën.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E kuptoj që kjo është një
9 temë shumë e rëndësishme. E kuptoni edhe qëndrimin tonë dhe ju
10 e thatë këtë. Por edhe unë e kuptoj plotësisht këndvështrimin
11 tuaj.

12 Unë mendoj se palët kanë nevojë për një vendim për
13 vendosjen në drejtpeshim të këtij problemi. Se kur flasim për
14 të mos ta mbyllur, pra mundësia për të vazhduar me njoftimin
15 pra është shumë e thjeshtë. Ju e kuptuat shumë mirë.

16 Por do të ishte shumë mirë të kishim një vendim, një
17 vendim shumë të qartë, se na ndihmon të gjithëve neve në
18 marrëdhëniet tona, se kemi marrëdhënie të mira me ZPS-në dhe
19 nuk dua që të krijoj një problem të tillë. Jam i sigurt që nuk
20 ka paramendim, si të thuash nga ZPS-ja në mënyrën se si e
21 trajton këtë informacion. Mund të jetë thjesht një keqkuptim -
22 -

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Një moment t'ju ndërpres
24 zoti Gilissen se e shikoj që është ndërprerë lidhja me zotin
25 Shala.

1 Jam informuar se lidhja po rivendoset. Të presim derisa
2 të rivendoset lidhja dhe pastaj mund të vazhdoni në mënyrë që
3 zoti Shala të ndjekë çdo moment të seancës. Ju kërkoj ndjesë
4 zoti Gilissen, por dua të sigurohem që zoti Shala të jetë në
5 gjendje ta përcjellë seancë.

6 [Vështirësi teknike]

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Vërej se lidhja është
8 rivendosur.

9 Zoti Gilissen tani mund të vazhdoni. Ju kërkoj ndjesë që
10 ju ndërpreva.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] E kuptoj absolutisht vështirësinë
12 teknike.

13 Unë po flisja për faktin se kemi një marrëdhënie shumë
14 profesionale me ZPS-në. Do të doja që të vazhdonim me këtë
15 mënyrë.

16 Unë ju thashë, ju tregova që kjo nuk është asnjë [gjë] e
17 paramenduar nga ana e Prokurorisë. Pra të kuptohemi. Qëllimi
18 këtu është që procedura të jetë e drejtë për të gjithë. Për të
19 gjithë e them. Nëse ne do të zbulonin diçka, si për shembull
20 një dokument të cilin ne e konsiderojmë, me të drejtë ose jo,
21 nuk ka rëndësi, ne e konsiderojmë si shumë të rëndësishëm dhe
22 e zbulojmë shumë vonë këtë gjë, do të ishte gjynah për të
23 gjithë në qoftë se do të ndodhte kjo.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Gilissen.

25 Zoti Prokuror, doni të shtoni diçka?

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Shumë shkurt, sigurisht nëse do
2 të lindte një situatë e tillë, situata që e përshkroi zoti
3 Aouini, në rastin kur një dokument i cili nuk është përshkruar
4 në moment, ju lutem që të na kontaktojnë dhe jam i sigurt që
5 do të gjendet një zgjidhje, Për aq sa ajo -- pastaj kjo do të
6 kërkonte edhe ndërhyrjen e të nderuarit Gjykatës. Nuk duhet të
7 pengohet miratimi i një kërkesë të tillë.

8 Por nuk besojmë deri tani -- nuk mendojmë që për këtë
9 çështje t'i drejtohem të nderuarit Gjykatës. Besoj se do të
10 jemi në gjendje që të diskutojmë së bashku çdo rast të tillë
11 me Mbrojtjen.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Prokuror.

13 Unë nuk mendoj se mund ta zgjidhim këtë çështje brenda
14 seancës sot. Por mendoj se është e rëndësishme që shqetësimet
15 që Mbrojtja sapo i paraqiti të marrin zgjidhje.

16 Kështu që i kërkoj Mbrojtjes që të dorëzojë parashtrime
17 me shkrim. Të m'i drejtojë mua kur të prezantoni vështirësitë
18 me të cilat ju përballeni sa i takon nxjerrjes.

19 Por mendoj se do të ishte shumë e dobishme nëse këto
20 parashtrime t'i dorëzoni ndërkohë që ZPS-ja e ka finalizuar
21 nxjerrjen e materialit shfajësues. Sepse kjo gjithashtu mund
22 t'ju ndihmojë me problemet të cilat ju jeni përballur sa i
23 takon identifikimit të dokumenteve të rëndësishme. Për sa kohë
24 që nuk keni pasur nxjerrjen e rregullit 102(1)(b) dhe 103 nuk
25 do të jeni në gjendje që të jeni në dijeni për të gjitha

1 kriteret të cilat ju i mbani parasysh sa i takon për t'u
2 vendosur diçka nga lista.

3 Ju nxis që të vazhdoni diskutimet *inter partes*.

4 Prokuroria t'ju informojë për nxjerrjen e materialit
5 shfajësues dhe me shpresë brenda dy javësh apo tre apo tre e
6 gjysmë, zoti Prokuror i kërkoj Mbrojtjes që të më drejtohet në
7 atë moment me një përditësim sa i takon nxjerrjes dhe çdo
8 kërkesë të mundshme që mund të kenë. Por besoj se do të ishte
9 më efikase nëse kjo do të bëhet pasi ZPS-ja ta ketë finalizuar
10 shqyrtimin e rregullës 103.

11 Nëse nuk ka - zoti Prokuror, po.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Thjesht një përgjigje që ju
13 detyrohem për temën e rregullës 102(3) që kemi diskutuar më
14 herët. Më pyetët nëse parashikojmë ndryshime të ardhshme të
15 njoftimit të rregullës 102(3) dhe s'ju dhashë përgjigje për
16 këtë.

17 Parashikojmë se kjo do të jetë e mundshme nëse -- kur të
18 marrim autorizimet për dokumentet e rregullës 107. Gjithashtu
19 ZPS-ja i vazhdon hetimet e veta në kuadër të mandatit që ka.
20 Kështu që nëse - edhe në kuadër të kësaj kërkohet një shqyrtim
21 periodik nga ana e ZPS. Nëse do të ketë dokumentet që kanë
22 rëndësi dhe kanë lidhje me këtë çështje ne do ti bëjmë një
23 përditësim [e pakuptueshme].

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E mbajta shënim.

25 Kalojmë tani te çështja e përkthimeve të parashtrimeve të

1 protokolluara të materialit provues. Në parashtrimet e veta
2 ZPS-ja ka bërë të ditur se palët i vijnë diskutime lidhur me
3 përkthimin e materialeve provuese dhe se ZPS-ja -- materialet
4 provuese të cilat ZPS-ja nuk synon t'i përdorë në gjykim.

5 Vë re se Mbrojtja ka bërë të ditur në parashtrimet e veta
6 se gjithashtu i ka bërë kërkesë për përkthime dhe për dhënien
7 prioritet përkthimit të materialit specifik. U lutem palëve që
8 të prezantojnë çdo problem tjetër lidhur me përkthimet.

9 Do ta filloja me Mbrojtjen.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kemi
11 kërkuar përkthim të materialit provues nga Zyra
12 Administrative. Por kemi filluar kontaktet me disa elemente të
13 Zyrës Administrative, në këtë mënyrë do t'i informojmë në
14 konferencën e ardhshme për ecurinë e çështjes për progresion e
15 bërë në lidhje me këtë.

16 Ajo që mund të themi është se deri tani ne kemi mundur të
17 mbështetemi në burimet tona të brendshme lidhur me këtë. Por
18 marrjen e qindra dokumenteve nga njoftimi, ne sigurisht do
19 t'ju kërkojmë ndihmë Zyrës Administrative për shërbime
20 përkthimore.

21 Duhet të shtoj se edhe parashtrimet e protokolluara që na
22 ka dhënë Zyra Administrative, në formën draft pra të
23 papërfunduar të kërkesës, siç u bë edhe siç u tha [[e
24 pakuptueshme] e falënderojmë Zyrën Administrative sepse kjo na
25 ndihmon shumë.

1 I nderuar Gjykatës, dua të shtoj se përkthimi i dosjes
2 paraprake të Prokurorisë në gjuhën shqipe duhet të trajtohet
3 me prioritet të lartë për Mbrojtjen.

4 Të vazhdoj edhe me pikën (b), i nderuar Gjykatës? Po. Që
5 prej konferencës së fundit për ecurinë e çështjes kemi
6 diskutuar me kolegë të ZPS dhe gjatë pushimit dimëror kemi
7 shqyrtuar dokumentin në fjalë për të cilën nuk kemi përkthim.
8 Kemi përgatitur një listë të shkurtër prioritetesh dhe do t'ia
9 dorëzojmë Prokurorisë. Jam i sigurt se do të vijojmë me
10 diskutimin me qëllim të marrjes së përkthimeve të atyre që
11 janë më të rëndësishme.

12 Ndërkohë, i kërkojmë ZPS përkthimin e disa dokumenteve që
13 janë me interes për ne të cilat i kemi marrë në bazë të
14 kërkesës që i kemi bërë në bazë të njoftimit. Dhe kemi bërë
15 kërkesa në formë *ad hoc* dhe kolegët nga ZPS-ja na kanë dhënë
16 përkthimin që e kishin dhe i falënderojmë për këtë. Ju
17 falënderojmë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Gilissen.

19 Zoti Prokuror.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Asgjë nga ana jonë, i
21 faleminderit Gjykatësit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Zoti Nilsson, a mund të mbani shënim kërkesën e Mbrojtjes
24 për t'ia dhënë prioritet përkthimit të dosjes paraprake
25 gjyqësore të ZPS në gjuhën shqipe?

1 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, po do ta mbajmë
2 shënim këtë kërkesës.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit zoti Nilsson.

4 Më lejoni tani të kaloj në pikën e tretë të rendit të
5 ditës, që është ecuria e hetimeve të ZPS dhe hapat në vijim.

6 Përpara se të diskutojmë këtë çështje dua të pyes ZPS-në
7 nëse është e nevojshme të kalojmë apo jo në seancë private.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po i nderuar Gjykatës për të
9 mbrojtur konfidencialitetin e hetimeve kjo do të ishte e
10 nevojshme.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit zoti Prokuror.

12 Zoti Sekretar, ju lutem të kalojmë në seancë private.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike i
17 nderuar Gjykatës.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Për pikën tjetër të rendit të ditës, dëshiroj që t'i
20 drejtohem fillimisht Mbrojtjes.

21 Vërej nga parashtrimet me shkrim të Mbrojtjes se ajo ende
22 nuk është në gjendje që të na japë ndonjë informacion mbi
23 kohëzgjatjen e parashikuar apo mbi ecurinë e aktiviteteve
24 hetimore të saj.

25 Vë re gjithashtu që Mbrojtja në këtë moment nuk është në

1 gjendje të konfirmojë se do të bëjë ndonjë kërkesë lidhur me
2 mundësinë unike hetimore apo nëse do të japë njoftim alibie
3 apo për arsye të tjera që përjashtojnë përgjegjësinë penale.

4 I kërkoj Mbrojtjes që të japë informacion shtesë sa i
5 takon afatit të hetime apo për të bërë të ditur se kur mund
6 t'i bëjë këto parashtrime.

7 Zoti Gilissen keni fjalën.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Kam kënaqësinë të
9 raportoje se kemi ecur përpara me hetimet. Po përballemi edhe
10 me probleme siç mund ta imagjinoni. Problemi më i madh është
11 COVID-19 dhe gjithashtu disa prej anëtarëve të ekipit tonë
12 kanë rënë viktimë të kësaj sëmundjeje. Fatkeqësisht, një
13 anëtar i ekipit tonë ka humbur edhe një të afërm shumë të
14 afërt, e i japim asaj ngushëllimet tone edhe një herë.

15 Ndikimi që ka kjo në terren na cenon edhe mundësinë për
16 të punuar për të udhëtuar në atë mënyrë siç e kishim
17 parashikuar para pushimit dimër të Gjykatës.

18 Ky është një problem shumë i madh. Megjithatë, ne kemi
19 arritur të kemi progres. Në disa aspekte kemi identifikuar
20 objektivin kryesor të misionit tonë të parë në terren dhe po
21 bëjmë planet tona në bazë të informacionit që kemi marrë nga
22 terreni. Një mision të parë - pra udhëtimin tonë të parë [do
23 ta bëjmë] në fund të shkurtit, fillim të marsit, sigurisht në
24 vartësi edhe të kushteve shëndetësore në terren.

25 Kemi bërë punën përgatitore në lidhje me këtë dhe do të

1 vijojmë që të bëjmë punë përgatitore edhe në javët në vijim.

2 Gjithashtu, aktivisht kemi qenë në kontakt me disa
3 ekspertë të cilët mund të na ndihmojë në provat tona. Nuk mund
4 të themi më shumë tani. Por do t'ju informojmë për zhvillimet
5 më të fundit në konferencat e ardhshme për ecurinë e çështjes.
6 Faleminderit shumë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Gilissen.
8 Zoti Prokuror doni të përgjigjeni?

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Prokuror.

11 I kërkoj Mbrojtjes që të vazhdojë me këtë punë. E di që
12 është e ndërlikuar për shkak të situatës, por gjithsesi është
13 e rëndësishme që ju të vazhdoni me hetimet tuaja sa më shpejt.

14 Më lejoni të kaloj tani në pikën tjetër të rendit të
15 ditës, që janë pikat juridike dhe faktike për të cilat palët
16 pajtohen.

17 Në këtë aspekt vë re se palët kanë kryer diskutimet e
18 tyre për pika të mundshme juridike dhe faktike për të cilat
19 pajtohen. ZPS-ja e ka bërë të ditur në parashtrimet e veta se
20 do të jetë në gjendje që të identifikojë disa prej këtyre
21 aspekteve përmes dorëzimit të dosjes paraprake të ZPS. Por
22 vërej nga parashtrimet e Mbrojtjes se nuk mund të raportohet
23 progres për diskutimet e palëve sa i takon mundësisë për
24 parashtrimin e pikave juridike dhe/ose faktike për të cilat
25 pajtohen.

1 Mundet palët të na përditësojnë më shumë për këtë temë
2 sidomos se deri kur mund të bëjnë parashtrime lidhur me këtë
3 çështje.

4 Zoti Prokuror.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne kemi
6 ndërmend që të punojmë që t'i propozojmë disa fakte Mbrojtjes
7 për t'u pajtuar përpara dosjes paraprake dhe besoj se kjo do
8 ta vërë më në lëvizje procesin. Besoj se Mbrojtja pret që t'a
9 bëjmë ne lëvizjen e parë në këtë aspekt.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Prokuror.

11 Zoti Gilissen.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë. Nuk kam asgjë
13 për të shtuar. Vetëm se do të jetë kënaqësi që do të
14 diskutojmë për të gjitha këto tema. Faleminderit shumë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I kërkoj ZPS që ta vërë në
16 lëvizje procesin sa më shpejt pas dosjes paraprake atëherë.

17 Dëshiroj tani të pyes, t'i kërkoj Zyrës Administrative që
18 të na japë një përditësim për COVID-19 mbi masat mbrojtëse që
19 janë marrë në qendrën e paraburgimit dhe në veçanti nëse ka
20 ndryshuar apo jo regjimi pas përditësimit të pestë të Zyrës
21 Administrative për masa të tilla.

22 Z. NILLSON: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar
23 Gjykatës.

24 Sipas përditësimit të fundit të 1 dhjetorit unë pas atij
25 njoftimi kam një njoftim tjetër.

1 Janë zbatuar masat e vizitave të kufizuara deri në fund
2 të nëntorit në objektin e paraburgimit në bazë të këshillave
3 të mjekut të njësisë së paraburgimit. Vizitat personale me
4 anëtarë të familjes dhe me avokatët kanë vazhduar prej datës 7
5 dhjetor.

6 Duke marrë parasysh rrethanat e COVID-19 në Holandë dhe
7 në vende të tjera, mjeku na ka udhëzuar që të kemi një qasje
8 të kujdesshme në heqjen e masave të tjera kufizuese.

9 Pra, këtu jemi për momentin. Të gjithë të paraburgosurit
10 janë të informuar në fazat e duhura për masat përkatëse.
11 Administratorja po e monitoron situatën vazhdimisht dhe është
12 në konsultime të vazhdueshëm me mjekun e njësisë së
13 paraburgimit për heqjen e plotë të masave kufizuese.

14 Dhe do të vazhdojmë që t'ju informojnë në lidhje me
15 zhvillimet e mëtejshme rregullisht, i nderuar Gjykatës.
16 Faleminderit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit zoti
18 Nilsson.

19 A ka Mbrojtja diçka për të thënë lidhur me këtë
20 përditësim.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo nuk kemi kurrfarë pyetjeje.
22 Ishte një prezantim i plotë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në këtë pikë tani do t'i
24 ftoj palët që të ngrenë ndonjë çështje tjetër që duan të
25 ngrenë dhe që nuk është përfshirë në rendin e ditës.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë pikë tjetër për
2 të ngritur.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Gilissen.

4 Z. AOUBINI: [Përkthim] Do të jem unë i nderuar Gjykatës.

5 Për hir të procesverbalit do të përmend një çështje të

6 shkurtër në pritje të dosjes paraprake.

7 Pas konferencës së parë për ecurinë e çështjes apo

8 ndoshta midis të parës dhe të dytës kemi biseduar me kolegët e

9 ZPS dhe kemi bërë një kërkesë që në sistemin Lega Workflow të

10 krijohen pikat në lidhje me dëshmitarët apo subjektet në

11 lidhje me dëshmitarët.

12 Kemi bërë diskutime me kolegët e ZPS në lidhje me këtë

13 dhe ata u pajtuan që t'a bëjnë këtë dhe na thanë që kjo mund

14 të zbatohet vetëm në një fazë më të vonshme që është pas

15 dorëzimit të dosjes paraprake dhe tabelës.

16 Pra, thjesht për t'a përmendur për procesverbalin, jemi

17 në diskutime dhe në marrëveshje për një kohë të gjatë tani.

18 Besojmë që kjo do të na ndihmojë në një masë mjaftueshme që të

19 identifikojmë, konfirmojmë dhe rishikojmë të gjitha link-et apo

20 lidhjet në lidhje me materialet që na janë nxjerrë deri tani.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Aouini.

22 Zoti Prokuror a mund të konfirmoni edhe një herë

23 gatishmërinë e Prokurorisë që t'i krijojë këto subjekt-

24 dëshmitarë, rubrika për dëshmitarë. Dhe nëse do të vazhdojnë

25 me dorëzimin e dosjes paraprake dhe rregullës 109 sipas

1 planit.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po i nderuar Gjykatës,
3 konfirmoj se do të vazhdojmë të jemi të gatshëm që t'i
4 krijojmë këto rubrika për dëshmitarët dhe konfirmojë se do ta
5 bëjmë dorëzimin e dosjes paraprake dhe të tabelës 109 brenda
6 afatit të paraparë prej jush.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Prokuror.

8 Tani do t'u kërkoj palëve që të më thonë se kur janë të
9 disponueshëm për konferencën e ardhshme të ecurisë së
10 çështjes.

11 Data që kam unë parasysh është e premte, 4 mars 2022 në
12 orën 14.30.

13 E përsëris e një herë, e premte, 4 mars 2022, në orën
14 14.30.

15 A i konvenon kjo kohë Prokurorit?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] zoti Gilissen?

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Me gjithë dëshirë do të doja të
19 thoja "po", por është pak e vështirë sepse shpresojmë që të
20 jemi gjallë deri atëherë. Pra e them "po", do të përpiqem që
21 të jemi gati brenda kësaj date.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë a mund edhe një
23 herë të biem dakord që brenda dy javësh të më konfirmoni datën
24 e misioneve që keni parasysh në qoftë se nuk jeni të
25 disponueshëm për datën 4 mars. Në qoftë se kjo është e vetmja

1 datë e mundshme që të shkoni për misione hetuese. Atëherë këtë
2 duhet ta keni si prioritet, unë nuk do t'i vonoj misionet
3 tuaja.

4 Ju e dini që salla e gjyqit është mjaft e zënë kohëve të
5 fundit dhe do të ishte mirë që të më njoftoni brenda dy javësh
6 për datat e mundshme në mënyrë që të gjejmë momentin e
7 përshtatshëm për mbajtjen e konferencës së ardhmes.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju faleminderit. Brenda dy javësh
9 do t'ju japin informacionin e kërkuar.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti
11 Gilissen. Do ta merrni edhe urdhrin për caktimin e datës që do
12 të përfshijë edhe rendin e ditës për atë konferencë mbi
13 ecurinë e çështjes edhe palët që të paraqesin parashtrime e
14 tyre me shkrim në lidhje me pikat që duan të ngrenë në
15 konferencën e ardhshme.

16 Me kaq përfundon seanca e sotme.

17 Falënderoj palët, falënderoj përkthyesit, stenografët,
18 teknikët audiovizial dhe personalin e sigurisë.

19 E shoh që është ora 16.01. e kam vonuar një minutë për
20 përkthyesit por besoj që do të ma falin.

21 --- Seanca përfundon në orën 16.01

22

23

24

25